



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT EKONOMIK, KULTURËS DHE TURIZMIT

## Njoftim për dëgjese publike

**Titulli i Projekt-vendim:** “Dëgjese publike me grupet e interesit për konsultimin e konceptit të projektit “Rivitalizimi i Kalasë së Elbasanit” (BID – Kalaja e Elbasanit)”.

**Propozuesi:** Bashkia Elbasan.

**Projektues:** Studio arkitekturore MVM Arkitekture dhe arkitekt Emre Arolat.

**Financues i përgatitjes së projektit:** Fondacioni Shqiptaro Amerikan për Zhvillim - AADF.

**Sqarime për projekt-aktin:** Informim i grupeve të interesuara dhe komunitetit të Bashkisë Elbasan dhe në veçanti të Lagjes Kala mbi koncept-projektin e “Rivitalizimit të Kalasë së Elbasanit” (“BID - Kalaja e Elbasanit”).

Aprovimi i këtij Koncepti dhe zbatimi i Projektit konsiderohet se do të sjellë vlerë të shtuar për ekonominë e banorëve dhe bizneseve të lagjes Kala dhe të qytetit të Elbasanit.

Sqarojmë se projekti ndodhet në fazë konceptuale dhe konsultuese. Qëllimi i kësaj dëgjese është mbledhja e mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit përpara vijimit të çdo hapi të mëtejshëm institucional. AADF mbështet procesin nëpërmjet financimit të ekspertizës dhe asistencës teknike, ndërsa vendimmarrja, procedurat administrative dhe zbatimi i çdo ndërhyrjeje mbeten përgjegjësi e institucioneve publike kompetente, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

**Qëllimi:** Nëpërmjet këtij konsultimi synohet të mblidhen sugjerimet e komunitetit dhe grupeve të interesit, privat dhe publik, banorë dhe biznese të lagjes Kala, dhe jo vetëm, lidhur me:

- Vizionin dhe metodologjinë e propozuar nga grupi projektues për një masterplan të udhëhequr nga konservimi, i mbështetur nga një qasje e akupunkturës urbane. Duke i dhënë përparësi rehabilitimit si mjeti kryesor i transformimit, si dhe duke u fokusuar në përmirësimin e kujdesëshëm të strukturave ekzistuese, duke ruajtur njëkohësisht shtresëzimet e tyre kohore. Në përgjithësi synohet;

- Restaurimi i ndërtesave të trashëgimisë, përmirësime selektive të fasadave të bazuara në kritere konservuese dhe urbanistike si dhe shtime në shkallë të vogël - të projektuara për të forcuar vazhdimësinë hapësinore dhe përdorimin e përditshëm të zonës;
- Përmirësimi gradual i sipërfaqeve të rrugëve, ndriçimit dhe infrastrukturës për këmbësorët;
- Krijimi i hapësirave të vogla publike dhe rritja e cilësisë së hapësirës publike;
- Integrimi i synuar i funksioneve kulturore dhe komunitare;
- Trajtimi i Lëvizshmërisë duke identifikuar problemet dhe duke propozuar zgjidhje përkatëse.

**Kalendari i konsultimit:** Dëgjesa publike do të realizohet me datë **24 qershor 2026, ora 11:00**

**Pjesëmarrës:**

- **Nga ana e Bashkisë:** Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Territorit Urban, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve Buxhetit dhe Financës, Koordinatori për Informim dhe Konsultim, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, përfaqësues të Sekretariatit të Këshillit Bashkiak.
- **Nga komuniteti:** përfaqësues të komunitetit të banorëve të lagjes “Kala”, bizneseve të lagjes “Kala”, përfaqësues institucioneve religjioze, të organizatave jofitimprurëse, ekspertë lokal, etj.
- **Nga bashkëpunëtorët:** Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Konomisë dhe Inovacionit, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Qarkut Elbasan, Ujësjiellës Kanalizime Elbasan Sh.A. (UKE), Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) - Drejtoria Rajonale Elbasan, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) - Njësia Operative Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës - Drejtoria Vendore Elbasan, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korçë (DRTK), Gjendja Civile Elbasan, etj.
- Përfaqësues nga grupi projektues - studio arkitekturore MVM Architecture dhe ark Emre Arolat.
- Përfaqësues nga Fondacioni Shqiptaro Amerikan për Zhvillim (AADF).
- **Format e konsultimit:** Takim i hapur publik, në datën 24 qershor 2026, në ambientet e Bashkisë Elbasan, salla multifunksionale.

Gjithashtu mund të merrni pjesë duke u bërë pjesë e sugjerimeve dhe rekomandimeve edhe nëpërmjet emailit: [bashkiaelbasan@elbasani.gov.al](mailto:bashkiaelbasan@elbasani.gov.al), duke dhënë sugjerime dhe rekomandime,

referuar projektit konceptual “Rivitalizimi i Kalasë së Elbasanit”, të cilin e gjeni në linkun si me poshtë:

<https://elbasani.gov.al/njoftim-per-degjese-publike-projekti-rivitalizimi-i-kalase-se-elbasanit/>

<p>Qëllimi i këshillimit publik</p>	<p>Dëgjesa publike synon tërheqjen e mendimit të qytetarëve, biznesit, shoqërisë civile, strukturave komunitare në lidhje me përmirësimin e konceptit të projektit të “Rivitalizimit të Kalasë së Elbasanit” (BID – Kalaja e Elbasanit”).</p> <p>Mbledhja e mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit, do t’i shërbejë Bashkisë Elbasan dhe grupit projektues, për të përcaktuar se si do të arrijë vizionin e përbashkët në rivitalizimin e Kalasë së Elbasanit me një model turizmi dhe zhvillimi biznesesh.</p>
<p>Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-vendimi</p>	<p>Miratimi i projektit të zbatimit të “Rivitalizimit të Kalasë së Elbasanit” (BID – Kalaja e Elbasanit”) është një vendim i rëndësishëm që merret nga institucionet publike shqiptare. Pasi koncept- projekti dhe projekti i detajuar teknik të aprovohet nga institucionet publike përkatëse, do të merret nga Bordi i Fondacionit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit vendimi për financimin e zbatimit të projektit, duke përcaktuar fondet që do të përdoren në përputhshmëri me zbatimin e projektit dhe të bashkëpunimit me Bashkinë Elbasan dhe Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, si dhe të plotësimit të masave të planifikuara në këtë projekt.</p>
<p>Pyetjet që ngre Bashkia ndaj publikut</p>	<p>Bashkia Elbasan ka marrë nëpërmjet AADF koncept-projektin “Rivitalizimi i Kalasë së Elbasanit” (BID – Kalaja e Elbasanit”, përgatitur nga grupi projektues, kontraktuar nga AADF. Bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Bashkia Elbasan vijon procesin e konsultimit publik të projektit sipas metodologjisë së përcaktuar nga baza ligjore.</p>
<p>Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktin për këshillim;</p>	<p>Bashkia Elbasan do të organizojnë dëgjësën publike në datë 24 qershor 2026, ora 11:00, në ambientet e Bashkisë Elbasan, salla multifunktionale. Ky takim do të organizohet me pjesëmarrjen e të palëve të interesuar, ftuar nëpërmjet këtij njoftimi publik dhe ftesave dërguar nga bashkia Elbasan drejtuar banorëve dhe bizneseve të lagjes Kala si dhe përfaqësuesve të institucioneve publike dhe religjioze.</p> <p>Grupet e interesit publik ftohen të marrin pjesë, sikurse ata që e kanë të pamundur pjesëmarrjen, janë të lutur të dërgojnë sugjerimet e tyre me email: <a href="mailto:bashkiaelbasan@elbasani.gov.al">bashkiaelbasan@elbasani.gov.al</a>.</p>
<p>Kontaktet dhe afatet e</p>	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja mund të jepen direkt nëpërmjet <b>pjesëmarrjes suaj në dëgjësën publike</b>, ose në pamundësi për të marrë pjesë në këtë konsultim do të na ndihmoni duke dhënë sugjerimet pranë</p>

dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	zyrës me një ndalesë të Bashkisë Elbasan, si dhe duke kontaktuar me përfaqësuesin e komunitetit të Rajonit, si dhe mund të dërgohen në <b>postën elektronike në adresën e emailit të Bashkisë Elbasan: <a href="mailto:bashkiaelbasan@elbasani.gov.al">bashkiaelbasan@elbasani.gov.al</a></b> ose të dërgohen <b>me postë brenda datës 4 korrik 2026, në adresën: Bashkia Elbasan, rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.</b>
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundëshme për t’u shqyrtuar nga ana e Këshillit: Ndryshime në prioritizimin e nevojave për ndërhyrje me plan masash me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.
Projekt-vendimi, relacioni shoqëruar, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet	Koncept Projekti prezantues i “Rivitalizimi i Kalasë së Elbasanit” (BID – Kalaja e Elbasanit”), gjendet në linkun tek faqja zyrtare e bashkisë Elbasan: <a href="https://elbasani.gov.al/njoftim-per-degjese-publike-projekti-rivitalizimi-i-kalase-se-elbasanit/">https://elbasani.gov.al/njoftim-per-degjese-publike-projekti-rivitalizimi-i-kalase-se-elbasanit/</a>
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Bashkia Elbasan sëbashku me Këshillin për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas realizimit të konsultimeve publike me komunitetin dhe grupet e interesit, Bashkia Elbasan do të ndjekë hapat si vijon: 1. Mbajtja e procesverbalit të takimit publik dhe bërja publike e tyre. 2. Marrja e Rekomandimeve me postë dhe bërja e tyre publike. 3. Realizimin dhe përmbledhje të rekomandimeve, që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje. 4. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh AADFsë, grupit projektues dhe drejtorive të linjës në bashkinë Elbasan. 5. Diskutimi me grupin e projektimit dhe AADF. 6. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projektin e zbatimit. 7. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të Rekomandimeve, ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre.
Data e publikimit	4 qershor 2026
Përgjegjës:	Spektori i Konsultimit Publik sëbashku me Koordinatorin për konsultim dhe me Drejtorinë e Inovacionit dhe Medias, pranë Bashkisë Elbasan.